A.1	Shpenzime për ceremonialin zyrtar	1,500		1,500	
Shuma		1,500		1,500	
f) Periudha e zbatimit: Gjatë vitit 2023,2024,2025		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: 1.Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër			

Nr. 17	P01110.Q2.O2.A9. Shërbim Interneti për Institucionin e Bashkisë së Shkodrës	Funksioni 1: Shërbime të Përgjithshme Publike N/Funksioni 011: Organet ekzekutive dhe legjislative, për çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme. Programi 01110: Planifikim Menaxhim dhe Administrim.					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i. Situata							
Bashkia Shkodër merr shërbimin e internetit sipas dispozitave ligjore në fuqi, të komunikimit elektronik të përcaktuara nga AKSHI. Bashkia Shkodër ka implementuar një sistem të qendëruar të marrjes së shërbimit të internetit në Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative, Lagje dhe Qendra Komunitare. Zgjidhja e implementuar ofron 99.99% shërbimin në çdo kohë në çdo pikë të tij. Arkitektura e komunikimit siguron një linjë back up emergjente për të gjitha linjat e komunikimit. Sistemi siguron konfidencialitetin dhe sigurinë e informacionit që trasmetohet në linjat e komunikimit. Të gjithë pikat e furnizuara të Bashkisë Shkodër kanë akses në internet 24/7 pa kufizim në komunikim. Ky shërbim ka rritur shpejtësinë në komunikim të të dhënave, ka ulur kostot operative për komunikimin e informacionit, ka garantuar mirëfunksionimin e sistemeve të bazuara në platforma web që Bashkia ka implementuar dhe ka shtrirë në të gjithë njësitë e saj administrative, si: Sistemi i Integruar i Zyrës me Një Ndalesë (SiZ1N), Sistemi i Integruar i Taksave dhe Tarifave Vendore (SiTTV), Sistemi i qendëruar kombëtar i shërbimeve të Ndhmës Ekonomike, Sistemi i Dixhitalizimit të Arkivave, e-Lejet, portali i Transparencës së Buxhetit, sistemi i integruar menaxhimit të Shërbimeve Sociale dhe Strehimit, faqja zyrtare e internetit www.bashkiashkoder.gov.al , menaxhimi i dokumentacionit dhe punës së përditshme të administratës vendore në rrugë elektronike, transparente dhe në kohë, etj.							
ii. Synimi i projektit							
Synohet ofrimi i shërbimit të internetit në Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative, Lagjet dhe Qendrat Komunitare të saj, në përputhje me standartet e përcaktuara për komunikimin elektronik.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ul style="list-style-type: none"> Ofrimi i shërbimit të internetit në Bashkinë Qendër, 10 Njësitë Administrative, 5 Lagjet, dhe në Qendrat Komunitare. Prokurimi i këtij shërbimit do të bëhet për një periudhë 3 (tre) vjeçare 							
b) Rezultatet që prisni							
<ul style="list-style-type: none"> Duhet të vazhdojë të funksionojë sistemi i ofrimit të shërbimit i qendëruar dhe i menaxhueshëm nga Bashkia Qendër. Zgjidhja e implementuar duhet të ofrojë 99.99% shërbimin në çdo kohë në çdo pikë të tij. Paketa nuk duhet të shfaqë një vonesë më të madhe se 110 ms bazuar në madhësinë minimale të një pakete standarde prej 32 bytes. Numri i paketave të humbura (në %) që nuk arrijnë në destinacion më e vogël se 3 (tre). Arkitektura e komunikimit duhet të sigurojë një linjë back up emergjente për të gjitha linjat e komunikimit. Sistemi do të sigurojë konfidencialitetin dhe sigurinë e informacionit që trasmetohet në linjat e komunikimit. Ofruesi i shërbimit nuk duhet të shohë, përdorë ose bëjë publike tek palë të treta informacionin e transmetuar në linjat e komunikimit. Të gjithë njësitë e Bashkisë Shkodër do të kenë akses në internet 24/7 pa kufizim në komunikim. Ky shërbim rrit shpejtësinë në komunikim të të dhënave, ul kostot operative, rrit transparencën dhe gjurmon informacionin. Ky shërbim garanton mirëfunksionimin e sistemeve të informacionit bazuar në platforma web dhe komunikim të brendshëm (intranet) që bashkia ka nën në funksion, që është në fazë shtrirje dhe implementim sistemesh të reja, si: Sistemi i Integruar i Zyrës me Një Ndalesë (SiZ1N), Sistemi i Informacionit të Taksave dhe Tarifave Vendore (SiTTV), Sistemi i qendëruar kombëtar i shërbimeve të Ndhmës Ekonomike, Sistemi i Dixhitalizimit të Arkivave, e-Lejet, portali i Transparencës së Buxhetit, sistemi i integruar i menaxhimit të Shërbimeve Sociale dhe Strehimit, faqja zyrtare e internetit www.bashkiashkoder.gov.al, menaxhimi i dokumentacionit dhe punës së përditshme të administratës vendore në rrugë elektronike, transparente dhe në kohë, etj. 							
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt			
<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse/ Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë/ Sektori i Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit Ofruesi i Shërbimit (Service Provider) i cili do të ofrojë shërbimin dhe asistencën teknike (sipas kushteve paraprake të vendosura në procedurat e prokurimit) Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër 				Bashkia Shkodër			
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shërbimi i internetit në Bashkinë Qendër, 10 Njësitë Administrative, 5 Lagjet, dhe në Qendrat Komunitare.	2,100			2,100		
Shuma		2,100			2,100		
		Totali	Nga kjo:				

Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		(mijë lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferi me	Kapitale
A.1	Shërbimi i internetit në Bashkinë Qendër, 10 Njësitë Administrative, 5 Lagjet , dhe në Qendrat Komunitare	2,100			2,100		
	Shuma	2,100			2,100		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferi me	Kapitale
A.1	Shërbimi i internetit në Bashkinë Qendër, 10 Njësitë Administrative, 5 Lagjet , dhe në Qendrat Komunitare	2,100			2,100		
	Shuma	2,100			2,100		
f) Periudha e zbatimit: Janar 2023 – Dhjetor 2025		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: 1.Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 18	P01110.Q2.O2.A10 Mirëmbajtje pajisje informatike	Funksioni 1: Shërbime të Përgjithshme Publike N/Funksioni 011: Organet ekzekutive dhe legjislativë, për çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme. Programi 01110: Planifikim Menaxhim dhe Administrim.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
Nevoja e administratës për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) ka qenë dhe është e domosdoshme. Gjatë viteve është bërë në vazhdimësi mirëmbajtja e pajisjeve ekzistuese TIK në Bashkinë Qendër dhe Njësitë Administrative të saj, janë kryer procedurë kalimi në inventar nga njëra drejtori në tjetrën. Disa pajisje TIK, kryesisht pajisje multifunksionale printer/skaner/fotokopje në varësi të karakteristikave dhe specifikimeve teknike që mbartin e kanë të nevojshme mirëmbajtjen e tyre në intervale të caktuara kohore për zëvendësimin e pjesëve të konsumueshme						
ii. Synimi i projektit						
Mbështetje e administratës vendore me një infrastrukturë optimale pajisjesh të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Identifikimi i pajisjeve informatike që kanë nevojë për mirëmbajtje teknike, përgatitja e specifikimeve teknike të nevojshme dhe preventivimi brenda fondit limit të miratuar bazuar në testimin e tregut. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> Pajisje të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në gjendje optimale funksionimi në përputhje me kapacitetet minimale teknike në mbështetje të punës së administratës vendore. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse/ Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë / Sektori i Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit Ofruesi i Shërbimit (Service Provider) i cili do të ofrojë mirëmbajtjen (sipas kushteve paraprake të vendosura në procedurat e prokurimit). Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër 				Bashkia Shkodër		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Identifikimi i pajisjeve TIK në nevojë të mirëmbajtjes teknike, specifikimi teknik i mirëmbajtjeve dhe preventivimi	600			600	
Shuma		600			600	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Identifikimi i pajisjeve TIK në nevojë të mirëmbajtjes teknike, specifikimi teknik i mirëmbajtjeve dhe preventivimi	300			300	
Shuma		300			300	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Identifikimi i pajisjeve TIK në nevojë të mirëmbajtjes teknike, specifikimi teknik i mirëmbajtjeve dhe preventivimi	300			300	
Shuma		300			300	
f) Periudha e zbatimit: Janar 2023 – Dhjetor 2025		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: 1. Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 19	P01110.Q2.O2.A11. Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)	Funksioni 1: Shërbime të Përgjithshme Publike N/Funksioni 011: Organet ekzekutive dhe legislative, përcështjetet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme. Programi 01110: Planifikim Menaxhim dhe Administrim.					
Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i. Situata							
Nevoja e administratës për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) ka qenë dhe është e domosdoshme. Gjatë vitit është bërë një rivlerësim i pajisjeve ekzistuese TIK në Bashkinë Qendër dhe Njësitë Administrative të saj, janë kryer procedura kalimi në inventar nga njëra drejtori në tjetrën, janë nxjerrë jashtë përdorimi pajisjet që nuk plotësojnë specifikimet teknike minimale të miratuara nga AKSHI, dhe një pjesë të konsiderueshme të këtyre pajisjeve është kryer shërbimi i mirëmbajtjes. Pajisje të reja TIK janë prokuruar nga Bashkia gjatë këtij viti, ndërkohë që nevojave për ripërtëritje të pajisjeve ekzistuese TIK është tejet e nevojshme dhe do të bëhet gradualisht nga viti në vit. Kjo nevojë vjen si rezultat i programeve të licensuara që duhet të përdorim në zbatim të Rregulloreve të AKSHI-t për Komunikimet Elektronik, asaj të Blerjeve të Pajisjeve TIK dhe plotësimi të standarteve minimale teknike, si dhe asaj të ofrimit të Shërbimeve të Përqendruara në Administratën Publike.							
ii. Synimi i projektit							
Mbështetje e administratës vendore me një infrastrukturë optimale pajisjesh të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
Identifikimi i nevojës për pajisje TIK, llojit dhe sasisë së tyre, përgatitja e specifikimeve teknike të nevojshme bazuar në rregulloren e specifikimeve teknike dhe preventivimi brenda fondit limit të miratuar bazuar në testimin e tregut.							
b) Rezultatet që prisni							
Pajisje të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në gjendje optimale funksionimi në mbështetje të punës së administratës vendore dhe në mbështetje të sistemeve të informacionit të implementuara dhe që do të implementohen në të ardhmen në Bashkinë Shkodër.							
c) Aktorët e mundshëm	d) Kontributet e mundshme në projekt						
<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse/ Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë / Sektori i Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit Ofruesi i Shërbimit (Service Provider) i cili do të ofrojë pajisjet. Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër 	Bashkia Shkodër						
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)	3,000					3,000
Shuma		3,000					3,000
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)	3,000					3,000
Shuma		3,000					3,000
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)	3,000					3,000
Shuma		3,000					3,000
f) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2023,2024,2025		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me NjëNdalesë Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 20	P01101.Q2.O2.A12 Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Informacionit të Bashkisë Shkodër	Funksioni 1: Shërbime të Përgjithshme Publike N/Funksioni 011: Organet ekzekutive dhe legjislative, për çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme. Programi 01110: Planifikim Menaxhim dhe Administrim.
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Bashkia Shkodër ka implementuar disa sisteme informacioni të integruara me qëllim ofrimin e shërbimeve elektronike ndaj qytetarëve, rritjen e aksesibilitetit ndaj këtyre shërbimeve, uljen e kostove dhe përmirësimin e cilësisë, rritjen e të ardhurave vendore dhe menaxhimin e tyre, përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies duke ftuar qytetarët në vendimmarrje, identifikimin e shtresave sociale dhe shërbimeve që marrin, etj.</p> <p>Gjithashtu ka shtrirë edhe Sistemin e Integruar të Zyrave me Një Ndalesë (SiZ1N) në të gjitha Njësitë Administrative dhe 5 Lagjet. Qytetarët dhe bizneset pavarësisht vendndodhjes së tyre mund të kërkojnë shërbimet administrative në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër. Qytetarët përfitojnë 82 shërbime, prej të cilëve disa ofrohen pa pagesë dhe disa të tjerë ofrohen kundrejt tarifave të miratuara në Paketën Fiskale. Faturimi bëhet përmes Sistemit të Integruar të Taksave dhe Tarifave Vendore (SiTTV). Po ashtu edhe kontrolli i shlyerjes së detyrimeve vjetore për bizneset apo individët para përfitimit të shërbimeve administrative të ofruara përmes SiZ1N, bëhet nga specialistët e drejtorisë së të Ardhurave të cilët aksesojnë SiTTV. Fluksi i kërkesave për shërbime administrative në Zi1N në të gjithë bashkinë është rritur ndjeshëm nga dita në ditë. Po ashtu SiTTV është konsoliduar dhe funksional në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër duke ofruar elektronikisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dokumentin e Paketës Fiskale • Qasjen e përdoruesve në aplikacion • Regjistrin e Bizneseve • Llogaritjen automatike e detyrimeve dhe gjenerimin e njoftimeve • Gjenerimin automatik të faturave • Regjistrimin e pagesave • Faturimin e Individëve • Verifikimin automatik për shlyerjen e detyrimeve vendore në SiZ1N dhe faturimin e shërbimeve me pagesë. <p>SiTTV i integruar me SiZ1N, janë të ngritur në platformën Smartprocesses në web app dhe së fundmi janë azhornuar edhe në mobile app (iShkodra). Ky azhornim (upgrade) i jep mundësinë qytetarëve dhe bizneseve të aplikojnë nga shtëpia, smartphone-i apo tableti i tyre për disa shërbime administrative që ofrohen përmes Zi1N apo të llogarisin e të tërheqin faturat e detyrimeve vjetore vendore.</p> <p>Një tjetër iniciativë e Bashkisë Shkodër është ajo e përfshirjes së qytetarëve në buxhetim përmes përdorimit të platformës online Transparenca e Buxhetit, një instrument Open Data i realizuar për herë të parë në Shqipëri. Ky instrument on-line informon publikun për të ardhurat vjetore të saj, shpenzimet dhe investimet, si dhe llogaritjen e taksave dhe tarifave vjetore të qytetarëve dhe bizneseve, si dhe i fton ato të shprehen on-line për kërkesa apo pakënaqësi të mundshme t'i drejtohen zyrave përkatëse përgjegjëse në Bashki për zgjidhjen. Në këtë portal bëhet publik çdo e dhënë mbi të gjitha të ardhurat në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, çdo shpenzim apo investim të bërë sipas programeve buxhetore (vlera të parashikuara, vlera të realizuar, datë fillimi dhe mbarimi i shërbimit/investimit, operatori ekonomik fitues i procedurës së prokurimit, foto ilustruese pas përfundimit dhe dorëzimit të shërbimit apo investimit, mundësinë e marrjes së sugjerimeve nga qytetarët) për çdo vit kalendarik të detajuar sipas programeve buxhetore. Instrumenti ofron një modul tjetër të rëndësishëm për llogaritjen vjetore të taksave dhe tarifave për secilin prej nesh, i programuar në zbatim të dokumentit të Paketës Fiskale. Çdo e dhënë e bërë publike gjeolokalizohet në hartën e Bashkisë Shkodër e mbështetur mbi platformën Google Maps. Instrumenti azhornohej vazhdimisht nga të gjithë drejtuesit e programeve buxhetore në varësi të gjendjes (statusit) në të cilin ndodhen procedurat (planifikuar = ikonë gjeolokalizuese e kuqe, në proces = ikonë gjeolokalizuese e verdhë, apo realizuar = ikonë gjeolokalizuese e gjelbër), si dhe çdo 3-mujor raportohet në total me të ardhurat e mbledhura apo të transferuara dhe shpenzimet e realizuara. Ky instrument është i ndërtuar mbi platformën Smartprocesse në web app dhe rezulton se vizitohet dhe monitorohet nga publiku përmes faqes zyrtare të internetit, tashmë është i azhornuar dhe në mobile app (iShkodra) duke u mundësuar instalimi i tij në çdo smartphone apo tablet duke informuar qytetarët përmes mesazheve njoftuese të aplikacionit për informacion të publikuar/azhornuar në kohë reale.</p> <p>Bashkia Shkodër ka implementuar edhe një sistem informacioni për Shërbimet Sociale. Qëllimi kryesor i implementimit të këtij sistemi është ofrimi i mundësisë për të populluar një bazë të dhënash të saktë me informacione mbi institucionet që ofrojnë shërbimeve sociale, si dhe mbi përfituesit që janë të regjistruar pranë këtyre institucioneve, në nivel vendor. Sistemi integron Drejtorinë e Shërbimeve Sociale në Bashki me Qendrat Komunitare në territorin e Bashkisë, duke ofruar mundësi për rritje të kontrollit mbi ushtrimin e aktivitetit të institucioneve si edhe rritje të transparencës mbi përfituesit e shërbimeve, në përputhje me ligjet në fuqi. Baza e të dhënave konsiston në identifikimin, regjistrimin dhe koordinimin e shërbimeve sociale që ofrohen në territor si dhe regjistrimin e përfituesve të të gjitha kategorive për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve në territorin administrativ. Baza e të dhënave përfshin modulët e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ofruesit e shërbimeve sociale vendore, brenda territorit të Bashkisë • Ofruesit e shërbimeve sociale vendore, jashtë territorit të Bashkisë • Regjistri i përfituesve të shërbimeve sociale vendore • Aplikues në proces • Puna në rrugë • Udhëzues për përdorimin e database • Baza Ligjore • Raporte <p>Sistemi informatik është i ndërtuar mbi platformën web Smartprocesses, dhe si e tillë aksesohet lehtë nga të gjithë përdoruesit në bashkinë Qendër apo në Qendrat Komunitare përmes shërbimit VPN.</p>		

Për të siguruar funksionimin dhe qëndrueshmërinë e këtyre sistemeve, Bashkia Shkodër në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe rregulloret e implementimit të sistemeve të informacioneve të miratuara nga AKSHI, duhet të sigurojë mirëmbajtjen e licensave dhe të sistemeve minimalisht për një periudhë 3-vjeçare.						
ii. Synimi i projektit						
Ofrimi i shërbimeve administrative elektronike aty ku qytetari dhe biznesi ndodhet, duke mundësuar që qeverisja vendore të shkojë drejt qytetarit në kohë të shkurtër, në mënyrë cilësore dhe transparente. Rritja e llogaridhënies financiare dhe e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Projekti Teknik për mirëmbajtjen e sistemeve Implementimi i Projektit Teknik, preventivimi dhe prokurimi Kapitalizimi i Projektit Testimi 						
b) Rezultatet që prisni						
Shërbimeve administrative ndaj qytetarëve dhe bizneseve dhe pjesëmarrjen e tyre në buxhetim dhe vendimmarrje të aksesueshëm nga faqja zyrtare e internetit dhe mobile app e Bashkisë Shkodër. Në këtë mënyrë garantohet reduktimi i kohës dhe kostove të shërbimeve, rritet transparenca, profesionalizmi, cilësia, korrektësia dhe lufta kundër korrupsionit.						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse/ Sektori i Menaxhimit të Projekteve TIK dhe Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me NjëNdalesë Ofruesi i Shërbimit (Service Provider) i cili do të ofrojë licencat e azhornimit të sistemit, asistencën teknike për mirëmbajtje (sipas kushteve paraprake të vendosura në procedurat e prokurimit) dhe trajnimet e stafeve sipasnevojës. Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër 				Bashkia Shkodër		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transf erime
A.1	Mirëmbajtje për Smart Processes Enterprise - Programi i SiZ1N për Bashkinë Qendër, 5 Lagjet dhe 10 Njesitë Administrative	710		710		
A.2	Mirëmbajtje SiZ1N në Mobile App	130		130		
A.3	Mirëmbajtje e Licencës së Programi i SiTTV për Bashkinë Qendër dhe nëNjësitë Administrative të saj	550		550		
A.4	Mirëmbajtje e SiTTV në Mobile App	128		128		
A.5	Mirëmbajtje e Mobile App të sistemeve të integruara të informacionit të bashkisë Shkodër - iShkodra	650		650		
A.6	Mirëmbajtja e platformës on-line Transparenca e Buxhetit	128		128		
A.7	Mirëmbajtje e Sistemit të Informacionit të Shërbimeve Sociale	560		560		
Shuma		2,856		2,856		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transf erime
A.1	Mirëmbajtje për Smart Processes Enterprise - Programi i SiZ1N për Bashkinë Qendër, 5 Lagjet dhe 10 Njesitë Administrative	710		710		
A.2	Mirëmbajtje SiZ1N në Mobile App	130		130		
A.3	Mirëmbajtje e Licencës së Programi i SiTTV për Bashkinë Qendër dhe nëNjësitë Administrative të saj	550		550		
A.4	Mirëmbajtje e SiTTV në Mobile App	128		128		
A.5	Mirëmbajtje e Mobile App të sistemeve të integruara të informacionit të bashkisë Shkodër - iShkodra	650		650		
A.6	Mirëmbajtja e platformës on-line Transparenca e Buxhetit	128		128		
A.7	Mirëmbajtje e Sistemit të Informacionit të Shërbimeve Sociale	560		560		
Shuma		2,856		2,856		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transf erime



A.1	Mirëmbajtje për Smart Processes Enterprise - Programi i SiZ1N për Bashkinë Qendër, 5 Lagjet dhe 10 Njesitë Administrative	710			710		
A.2	Mirëmbajtje SiZ1N në Mobile App	130			130		
A.3	Mirëmbajtje e Liçencës së Programi i SiTTV për Bashkinë Qendër dhe në Njesitë Administrative të saj	550			550		
A.4	Mirëmbajtje e SiTTV në Mobile App	128			128		
A.5	Mirëmbajtje e Mobile App të sistemeve të integruara të informacionit të bashkisë Shkodër - iShkodra	650			650		
A.6	Mirëmbajtja e platformës on-line Transparenca e Buxhetit	128			128		
A.7	Mirëmbajtje e Sistemit të Informacionit të Shërbimeve Sociale	560			560		
	Shuma	2,856			2,856		
f) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2023,2024,2025		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Sektori i Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të Z1N, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 21	P01110.Q2.O2.A13. Mirëmbajtje e faqes zyrtare web www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj	Funksioni 1: Shërbime të Përgjithshme Publike N/Funksioni 011: Organet ekzekutive dhe legjislative, përçështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme. Programi 01110: Planifikim Menaxhim dhe Administrim.										
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:												
i. Situata												
<p>Bashkia Shkodër zotëron faqen zyrtare interneti nën domain-in www.bashkiashkoder.gov.al. Kjo faqe është 24/7 on-line dhe aktualisht është një faqe e nivelit të III^{te} në përputhje me rregulloren e AKSHI-t për faqet zyrtare në administratën publike. Faqja është e ndërtuar mbi platformën web easyweb 2.0, një sistem i menaxhueshëm nga përdoruesit e bashkisë në nivel përmbajtjeje. Ofruesi i këtij shërbimi është përgjegjësi për host-imin, mirëmbajtjen teknike dhe ofrimin e shërbimit të adresave e-mail të stafit nën domain-in zyrtar. Në faqe janë të integruar disa module që mundësojnë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe demokracinë vendore në kuadër të mirëqeverisjes elektronike vendore. Moduli i Librarisë Ligjore i implementuar dhe i integruar në faqe, mundëson krijimin e vazhdueshëm të sondazheve me tematika të ndryshme dhe marrjen e mendimeve nga qytetari, lehtësisht i menaxhueshëm nga punonjësit e bashkisë. Moduli i SiZ1N, i integruar në faqen web, bën të mundur gjurmimin e kërkesave për shërbim të qytetarëve (tregon se në cilin status të aplikimit ndodhen shërbimet) që aplikohen në Zyrën e Integruar me Një Ndalesë në Bashkinë Qendër apo Njësitë Administrative, direkt nga portali zyrtar on-line. Shkarkimii formularëve on-line, informacioni i detajuar i regjistrit të kërkesave, raportet e auditimit, raportet financiare, buxheti dhe realizimi i tij, paketa fiskale, transparencja e buxhetit, raportimi online, forumi online, etj. në kuadër të programit të transparencës janë një tjetër mjet i përfshirjes së qytetarit përmes këtij portaliweb. Aktualisht faqja zyrtare e internetit e Bashkisë Shkodër është e një niveli të lartë informimi dhe përfshirëse e qytetarëve, kjo në kuadër të transparencës për zbatimin e të drejtës për informim ndër 61 bashkitë e vendit tonë.</p>												
ii. Synimi i projektit												
Synohet ofrimi i shërbimeve elektronike, forcimi i komunikimit virtual, llogaridhënës dhe transparent Bashki – Qytetar, Bashki-Biznes dhe anasjelltas (G2C / C2G, G2B / B2G).												
iii. Aktivitetet kryesore të projektit												
<ol style="list-style-type: none"> 1. Hostimi i Aplikimit 2. Suport 3. Shërbimi e-mail 4. Moduli i Librarisë Ligjore 5. Moduli i Forumit on-line 6. Formulari on-line për raportimet eqytetarëve 												
b) Rezultatet që prisni												
<p>Bashkia Shkodër do të zotërojë një faqe gjithnjë e më ndërvepruese me vizitorin (user-friendly) të strukturuar në mënyrën e duhur të tillë që informacioni i kërkuar të jetë i kapshëm në të shumtën 3 klikime. Do të ofrojë një qeverisje të hapur dhe transparente ndaj qytetarit dhe biznesit, duke bërë publike çdo vendim të institucionit, çdo investim të detajuar dhe me gjeoreferencë të lokalizuar, çdo të ardhur që mbledh, çdo shërbim që ofron, konsultim të detyrimeve vendore familjare dhe të biznesit, çdo informacion të saj direkt nga ky portal web. Do të konsultohet në mënyrë elektronike (virtuale) me qytetarin/biznesin përmes e-pjesëmarrjes në sondazhe apo publikime për të cilat kërkohet një konsultim virtual. Do t'i japë mundësi vizitorit të faqes të mund të komunikojë në një forum on-line apo të raportojë problematika të ndryshme përmes formularëve on-line. Përmes platformës së integruar Transparenca e Buxhetit do të gjurmohet bashkinë dhe administratën e saj në zbatimin e politikave fiskale dhe realizimit të investimeve dhe shërbimeve e planifikuara në çdo vit. Ky portal do të jetë mjeti që do të rris transparencën, luftën kundër korrupsionit, korrektësinë dhe cilësinë e punës së administratës vendore të institucionit.</p>												
c) Aktorët e mundshëm	d) Kontributet e mundshme në projekt											
<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse/ Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë • Komunikimi me Median • Drejtoritë përgjegjëse për përpunimin e informacionit për publikim në web sipas specifikave përkatëse. • Ofruesi i Shërbimit (Service Provider) i cili do të ofrojë host-imin dhe asistencën teknike (sipas kushteve paraprake të vendosura në procedurat e prokurimit) si dhe trajnimet e stafeve sipas nevojës. • Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër 	Bashkia Shkodër											
e) Shpenzimet e llogaritura												
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023	Totali (mijë lekë)	<table border="1"> <tr> <td colspan="5">Nga kjo:</td> </tr> <tr> <td>Paga</td> <td>Sigurime</td> <td>Operative</td> <td>Transferime</td> <td>Kapitale</td> </tr> </table>	Nga kjo:					Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
Nga kjo:												
Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale								

A.1	Mirëmbajtje e faqes zyrtare të internetit, www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj	300			300		
	Shuma	300			300		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Mirëmbajtje e faqes zyrtare të internetit, www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj	300			300		
	Shuma	300			300		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Mirëmbajtje e faqes zyrtare të internetit, www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj	300			300		
	Shuma	300			300		
f) Periudha e zbatimit Janar 2023 – Dhjetor 2025		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 22	P01110.Q2.O2.A14 Informimi i qytetarëve përmes mediave vizive për përfitimin e shërbimeve nga Bashkia Shkodër	Funksioni 1: Shërbime të Përgjithshme Publike N/Funksioni 011: Organet ekzekutive dhe legjislative, përçështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme. Programi 01110: Planifikim Menaxhim dhe Administrim.							
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:									
i. Situata									
<p>Bashkia Shkodër është institucioni i parë i qeverisjes vendore në Shqipëri që në respektim të parimit “qytetari në qendër” ka implementuar një model për ofrimin e Shërbimeve Administrative të Integruara të shtrirë tashmë në të gjithë territorin përmes hapjes së Zyrrave të Integruara me Një Ndalesë (Z11N) në Bashkinë Qendër, në të gjitha njësitë administrative dhe në 5 Lagjet e qytetit.</p> <p>Informimi mbi këto shërbime dhe mbi procedurat e përfitimit të tyre vazhdimisht u është prezantuar qytetarëve në takime të tematikave të ndryshme, në dëgjesa publike, përmes afishimeve të bëra dhe fushatave informuese me fletëpalosje në të gjitha Zyrrat me Një Ndalesë. Por njëkohësisht vlerësojmë informimin e qytetarëve për këto shërbime, dhe mënyrën e përfitimeve të tyre përmes mediave vizive lokale si një mjet tjetër i domosdoshëm komunikimi qytetar-qeverisje vendore.</p> <p>Informimi i qytetarëve përmes mediave audio vizive për përfitimin e shërbimeve nga Bashkia Shkodër, paraqitja e video spotit informativ për 5 njësitë bashkiake .</p>									
ii. Synimi i projektit									
Informimi dhe përfshirja publikut, një mjet i sigurtë për qeverisje të mirë.									
iii. Aktivitetet kryesore të projektit									
<ul style="list-style-type: none"> • Implementimi i informacionit për publikim viziv (video, reklamë, spot) • Identifikimi i mediave vizive lokale dhe kostove përkatëse për publikim të informacionit • Nënshkrimi i marrëdhënies kontraktuale • Publikimi i informacionit (video, reklamë, spot) 									
b) Rezultatet që prisni									
Informimi i qytetarëve për Zyrrat me Një Ndalesë më të afërta të Bashkisë Shkodër, për listën e shërbimeve administrative dhe përfitueshmërinë e tyre.									
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt					
<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse/ Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit • Ofruesi i Shërbimit (Service Provider), mediat vizive lokale • Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër 				Buxheti i Bashkisë					
e) Shpenzimet e llogaritura									
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023					Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
					Paga	Sigurime	Operative	Transfere	Kapitale
A.1	Publikimi i spotit televiziv në mediat vizive lokale	500			500				
Shuma					500		500		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024					Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
					Paga	Sigurime	Operative	Transfere	Kapitale
A.1	Publikimi i spotit televiziv në mediat vizive lokale	500			500				
Shuma					500		500		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025					Totali (mijëlekë)	Nga kjo:			
					Paga	Sigurime	Operative	Transfere	Kapitale
A.1	Publikimi i spotit televiziv në mediat vizive lokale	500			500				
Shuma					500		500		
f) Periudha e zbatimit					g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
Gjatë vitit 2023,2024,2025					1. Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Zyrës së Integruar me Një Ndalesë				
					Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				



<p>Nr.23</p>	<p>P01110.Q2.O2.A15 Sistem Informacioni i Integruar për Menaxhimin Financiar të Bashkisë Shkodër dhe Institucioneve të Varësive</p>	<p>Funksioni 1: Shërbime të Përgjithshme Publike N/Funksioni 011: Organet ekzekutive dhe legjislativë, për çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme. Programi 01110: Planifikim Menaxhim dhe Administrim.</p>
<p>a) Përshkrim i shkurtër i projektit:</p>		
<p>i. Situata</p>		
<p>Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", VKM nr 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial", Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji nr.68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Bashkia Shkodër, Qendër me kod institucioni 2141001, funksionon nëpërmjet programit Microsoft Office Excel.</p> <p>Në zbatim të Ligjit nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Udhëzimit nr.8 datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", detyra e Bashkisë Shkodër është përgatitja e paqyrave financiare të konsoliduara për të gjitha njësitë shpenzuese në varësi të saj. Prandaj, menaxhimi financiar përmes implementimit të një sistemi informacioni sipas standardeve kombëtare të kontabilitetit është tashmë një domosdoshmëri për Bashkinë Shkodër dhe njësitë shpenzuese të saj.</p> <p>Aktualisht Bashkia Shkodër përdor një version të programit Kontabiliteti Alpha Buxhetor të vitit 2004, i cili menaxhon vetëm veprimet e magazinës së Bashkisë qendër. Ky version ka nevojë të azhurnohet (upgrade) në një version të ri duke ruajtur dhe azhurnuar të dhënat ekzistuese gjatë këtyre 15 viteve përdorimi nga Bashkia Shkodër.</p> <p>Institucionet e Varësisë tek të cilët duhet të integrohet ky sistem informacioni janë:</p> <p>Drejtoria Ekonomike e Arsimit me Kod Institucioni 2141010 Drejtoria Ekonomike e Kulturës me Kod Institucioni 2141013 Teatri "Migjeni" me Kod Institucioni 2141017 Sport Klub "Vllaznia" me Kod Institucioni 2141028 Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve me Kod Institucioni 2141031 Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimet me Kod Institucioni 2141042 Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore me kod Institucioni 2141043</p> <p>Të gjitha këto institucione varësie mbajnë të dhënat përmes programit Microsoft Office Excel.</p> <p>Në situatën aktuale të Bashkisë Qendër dhe Institucioneve të varësisë vihen re një sërë problematikash si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Informacion jo i shpejtë mbi veprimtarinë e Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë: Programi Microsoft Office excel nuk gjeneron raporte direkt. Të gjitha informacionet bëhen nga specialistët e financës dhe duhet të kontrollohen për vërtetësinë dhe besueshmërinë e të dhënave, duke qenë se të dhënat hidhen manualisht 2. Mungesa e raporteve përmbledhëse për Bashkinë Qendër dhe Institucionet e Varësive ; Mungesë e raporteve përmbledhëse për gjendjen e likuiditeteve në arkë dhe në bankë; Mungesë e raporteve përmbledhëse për detyrimet ndaj furnitorëve; Mungesë e raporteve përmbledhëse për inventarin qarkullues në magazinë; Mungesë e raporteve përmbledhëse për situatën e llogarive kontabël; 3. Mungesë e pasqyrave financiare automatik , gjeneruar nga sistemi; Mungesë e pasqyrës përmbledhëse të konsoliduar e gjendjes financiare (Balanci); Mungesë e pasqyrës përmbledhëse e konsoliduar e të ardhurave dhe shpenzimeve; Mungesë e pasqyrës financiare përmbledhëse e Cash Flow; 4. Mungesë e monitorimit të veprimeve kontabël të rregjistruara nga Bashkia Qendër dhe institucionet e varësive; Programi Microsoft Excel nuk të lejon mundësinë për të lexuar dhe monitoruar si Bashkinë Qendër apo Institucionet e varësive kjo për të monitoruar veprimtarinë e tyre nëpërmjet një personi të autorizuar. 5. Mungesë e raporteve specifike ; Programi Microsoft Excel nuk të lejon të nxjerrësh raporte specifike duke bërë krahasimin e vlerave të buxhetuara me ato të realizuara; Mungesë e monitorimit të vlerave të realizuara; Mungesë e raporteve krahasuese për kategoritë e shpenzimeve; 		
<p>ii. Synimi i projektit</p>		
<p>Në kuadër të përmirësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, rritjes së transparencës të përdorimit të fondeve të Bashkisë Shkodër, si dhe për një menaxhim sa më ekonomik, eficient dhe efektiv të burimeve financiare, është e nevojshme instalimi i sistemit informacioni i integruar për Menaxhimin Financiar të Bashkisë Shkodër dhe Institucioneve të Varësive, për:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Menaxhimin e financave të Bashkisë Qendër dhe Institucionet e varësisë; ➤ Monitorimin e Institucioneve të Varësisë; ➤ Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; ➤ Raportimin e përmbledhur financiar; 		

Sistemi funksionon në Web ose në rrjet , duke u mundësuar punonjësve akses në çdo të dhënë për sistemin, përmes një kompjuteri. Të drejtat e aksesit për secilin punonjës, përcaktohen nga titullari i institucionit vetëm në atë pjesë të të dhënave që janë të domosdoshme për kryerjen e detyrës nga ky punonjës.

Ky sistem informacioni i integruar do të mundësojë raporte përmbledhëse të dhënash për të gjitha njësitë e varësisë dhe gjithashtu informacion të menjëhershëm për veprimet e tyre.

Sistemi mund të integrohet në çdo sistem informacioni ekzistues ose do të implementohet në të ardhmen.

Në këtë mënyrë do të realizohet:

- ✓ Ndërtimi sipas legjislacionit në lidhje me planin e llogarive, urdhërshpenzimet për marrëdhëniet me thesarin, listëpagesat sipas specifikave buxhetore;
- ✓ Sigurimin e raporteve standarte të kërkuara me ligj si: bilanci kontabël, PASH cash flow, libri i madh dhe një sërë raportesh të hollësishme për veprimet me thesarin, inventarët, debitorët, arkëtimet etj;
- ✓ Rregjistrimin e shpejtë të dokumentacionit të përditshëm ku përfshihen faturat, arkëtimet, urdhërshpenzimet, lëvizjet e inventarit dhe listëpagesat etj;
- ✓ Menaxhimin e burimeve njerëzore dhe gjenerimin e formateve zyrtare të raporteve për organizimin ISKSH-së dhe Zyrës së Punës;
- ✓ Ruajtjen e lëvizjeve të inventarit dhe aktiveve afatgjata të institucionit dhe kontrollimin e këtyre nëpërmjet raporteve.
- ✓ Kontabilizimin automatikisht të dokumentave;
- ✓ Menaxhim sipas parimit të 3E;
- ✓ Rritje e transparencës nëpërmjet kanaleve informatike të komunikimit (web portal, e-mail);
- ✓ Ndarja e funksioneve dhe përgjegjësisë, ndarja e proceseve të punës për çdo zyrë, sektor bazuar në një ndarje organizative të miratuar me ligj;

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

- 1) Sistem Informacioni i Integruar për Menaxhimin Financiar - Module Bazë
- 2) Sistem Informacioni i Integruar për Menaxhimin Financiar - Module Shtesë (asete, listë pagesa, e-payslip)
- 3) Mirëmbajtje e moduleve bazë
- 4) Mirëmbajtje e moduleve shtesë

b) Rezultatet që prisni

Sistem Informacioni i Integruar për Menaxhimin Financiar do të bëjë të mundur që:

- ✓ të drejtat e aksesit për secilin punonjës, përcaktohen nga titullari i institucionit vetëm në atë pjesë të të dhënave që janë të domosdoshme për kryerjen e detyrës nga ky punonjës;
- ✓ raporte përmbledhëse me informacion për Bashkinë Shkodër, dhe gjithë njësitë e varësisë dhe gjithashtu informacion të menjëhershëm për veprimet e tyre;
- ✓ lidhjen në kohë reale institucionin qendror me njësitë vartëse, të cilat nga ana e tyre rregjistrojnë të dhëna të pavarura nga njëra tjetra;
- ✓ marrja e informacionit në kohë reale mbi veprimtarinë e çdo institucioni vartës duke monitoruar veprimet kontabël të tyre, shpenzimet në buxhet, planifikimet, studimet, si dhe një sërë raportesh përmbledhëse dhe krahasuese;
- ✓ Bashkia Qendër dhe institucionet e varësive të gjenerojnë pasqyra të shumta mbi situatën e tyre kontabël, financiare dhe menaxheriale;
- ✓ informim në çdo kohë për debitorët, kreditorët dhe shpenzimet e secilës njësi shpenzuese.

c) Aktorët e mundshëm

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse
Drejtoria e Financës
Institucionet e Varësisë:

- Drejtoria Ekonomike e Arsimit
- Drejtoria Ekonomike e Kulturës
- Teatri "Migjeni"
- Sport Klub "Vllaznia" (Klubi Shumësportesh "Vllaznia")
